

REFERENCA E IDT AL - 14/2026

VENDI I LËSHIMIT SHQIPËRI

DATA E FILLIMIT TE VLEFSHMËRISË 16.09.2026

DATA E MBARIMIT TE VLEFSHMËRISË 15.09.2029

KODI I NOMENKLATURËS 6307 90 98

JUSTIFIKIMI I KLASIFIKIMIT Rregullat e përgjithshme Nr. 1, Nr. 2(a) dhe Nr. 6 për interpretimin e Nomenklaturës së Kombinuar. Shënimeve Shpjeguese të Sistemit të Harmonizuar për kreun 6307.

DATA E LËSHIMIT 16.09.2026

EMRI DHE ADRESA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
Tiranë, Autostrada Tiranë-Durrës, Km.1 (Pajtoni Center – Kati 5)

PËRSHKRIMI I MALLRAVE Produkti është një jastëk për prezantimin dhe mbajtjen e orëve, i projektuar posaçërisht për t'u vendosur brenda kutive të prezantimit të orëve. Produkti përbëhet nga: - Mbështjellje e jashtme prej pëlhure sateni me bazë viskoze. - Mbushje e brendshme prej shkume poliuretani fleksibël (Flexible PU Foam). Materiali tekstil mbulon plotësisht produktin dhe përbën sipërfaqen e jashtme të tij, ndërsa shkuma poliuretani shërben vetëm si mbushje e brendshme për ruajtjen e formës dhe mbështetjen e orës.

